

**KONTRATE DHURIMI E KUOTES TE KAPITALIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI  
TE KUFIZUAR**

**“D & B Kompani” sh.p.k**

1. **DHURUES: SALUEL BEZATI** i biri i Agim-it, lindur në Lushnje, i dtl. 23/11/1988, mbajtës i pasaportës biometrike Nr. BA9300544 dhe me Nr. Personal I81123054T, banues në Tiranë.
2. **PRANUES DHURIMI: ERJOLA BAJRAMI**, e bija e Vladimir, lindur në Elbasan, e dtl. 02/04/1991, mbajtëse e pasaportes biometrike Nr.5255985 dhe me Nr. Personal J15402115D, banuese në Tiranë.

**OBJEKTI I KONTRATES: Dhurimi i kuotes qe zoteron ortakut - Saluel Bezati te ortakut tjetër – pranuese e dhurimit Erjola Bajrami**


**NENI 1  
KUSHTET PARAPRAKE**

Kushtet paraprake te cilësisë se ortakut, te pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë, te regjistrimit te shoqërisë, te te drejtës per veprime juridike, si dhe Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqërisë D&B Kompani shpk, dt 20.05.2021, jane pjese thelbesore dhe integrale e kesaj kontrate dhurimi.

**NENI 2  
DHURIMI I KUOTES**

- 2.1 Dhuruesi z. Saluel Bezati, deklaron se eshte ortakut dhe zotërues e një (1) kuote qe përfaqëson 49% te kapitalit te shoqerise “D&B Kompani “ shpk, e cila (shoqeria) e ka vleren e kapitalit te saj 2.000.000 leke dhe shoqeria eshte regjistruar ne QKB ne dt. 03/06/2020 dhe mban Nr. NUIS M01803039I, dhe ka seline e saj ne adresen Njesia Bashkiake Nr. 5, Rr. Dervish Bej Mitrovica, Pall. Kristi – Co, Nr. 6, Kati perdhe, Dyqani Nr. 1, Tirane.
- 2.2 Nepermjet kesaj kontrate ortakut Saluel Bezati i dhuron dhe i transferon pronesine e kuotes se tij ortakut tjetër te shoqerise (pranuesit te dhurimit ne kete kontrate) znj.Erjola Bajrami, dhe kjo e fundit pranon dhurimin e kuotes qe zoteron dhuruesi pa asnje rezerve dhe me vullnet te plote.
- 2.3 Titulli i pronesise mbi kuoten do te transferohet prej dhuruesit drejt pranuesit te dhurimit menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin e kesaj kontrate dhurimi ne QKB.

**NENI 3  
PRANIMI I DHURIMIT**



3.1 Ortaku tjetër Erjola Bajrami, deklaron se e pranon dhurimin e kuotes se ortaku tjetër (dhuruesit) Saluel Bezati, dhe nga casti i regjistrimit te kesaj kontrate dhurimi ne QKB, do te jete Ortaku i Vetem i shoqerise D& B Kompani shpk, dhe kjo e fundit do te jete nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem.

**NENI 4**  
**ZGJIDHJA E MOSMARVESHJES**

Palet angazhohen te zgjidhin me mirekuptim cdo mosmarveshje qe lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kesaj kontrate dhe vetem kur nje zgjidhje e tille nuk eshte e mundur mosmarveshja do te kaloj per zgjidhje ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**NENI 5**  
**E DREJTA E ZBATUESHME**

Kjo kontrate dhurimi do te rregullohet ne baze te se drejtes shqiptare ne fuqi.

**NENI 6**  
**VLEFSHMERIA-ORIGJINALET**

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe palet deklaruan se jane dakort me sa me sipër, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht me date 20.05.2021.

**DHURUESI**

Saluel Bezati

**PRANUESI I DHURIMIT**

Erjola Bajrami  
Cojrami

Jep pëlqimin bashkëshortja e DHURUESIT

Fatjeh Blaceri

